

Course Name : Filozofi e së Drejtës							
Course Code	Course Type	Regular Semester	Lecture (hours/week)	Seminar (hours/week)	Lab. (hours/week)	Credits	ECTS
LAW 108	N/A	Spring	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lecturer		Ilirjana Kaceli, Prof. Asoc. Dr.					
Assistant		Ermira Shkreta, Msc					
Course language		Albanian					
Course level		Program i Integruar					
Description		Filozofia e së drejtës kërkon t'i japë studentit njohuri bazë të jurisprudencës, duke prezantuar studentin me shkollat më të rëndësishme të jurisprudencës si dhe me karakteristikat dhe dallimet përkatëse mes tyre. Kursi gjithashtu analizon koncepte themelore ligjore si drejtësia, ligji, morali, etika etj.					
Objectives		Ky kurs synon: 1. T'u japë studentëve njohuri bazë për studimin dhe kuptimin e jurisprudencës. 2. T'i pajisë studentët me konceptet bazë të filozofisë ligjore. 3. Të trajtojë teorinë e ndryshme ligjore 4. Të ndërtojë infrastrukturen ideore dhe teorike për disiplinat e tjera të programit. 5. Të zhvillojë tek studentët mendimin kritik në analizimin e situatave të ndryshme teorike dhe praktike. 6. Të nxisë debatin konstruktiv mes studentëve lidhur me qasjet e tyre ndaj teorive të ndryshme të filozofisë.					
Core Concepts		1. Jurisprudenca 2. E drejta natyrore 3. Pozitivizmi ligjor 4. Kontrata Sociale 5. Utilitarizmi 6. Realizmi ligjor					
Course Outline							
Week	Topic						
1	Hyrje e përgjithshme në filozofinë e së drejtës Tema hyrëse e lëndës e cila bën një trajtim të përgjithshëm të filozofisë së ligjit duke dhënë disa përkufizime mbi të, duke identifikuar çështjet që mbulon lënda si dhe rolin dhe vendin që mban kjo lëndë në sistemin tonë ligjor. Gjithashtu, ndalet në disa terma të rëndësishme dhe të nevojshme për studentët në vazhdim të lëndës. (Fq. 12-26)						
2	Teoria e së drejtës natyrore Ky leksion shqyrton me detaje teorinë e parë kryesore të së drejtës që është e drejta natyrore duke e analizuar atë që në zanafillën e saj dhe duke dhënë karakteristikat e saj kryesore dhe dy drejtimet që ka ndjekur, konkretisht teorinë teologjike dhe laike. (Fq. 27-37)						
3	Zhvillimi historik i së drejtës natyrore Zhvillimi historik i së drejtës natyrore analizohet që nga fillimet e hershme duke kaluar tek periudha klasike, periudha mesjetare dhe më pas tek hapat e parë drejt laicizmit të kësaj teorie. Krahas këtyre, trajtohet edhe raporti mes të drejtës natyrore dhe kontratës sociale. Në përfundim jepen vlerësime dhe kritika të teorisë nga autorë të ndryshëm. (Fq. 37-83)						
4	Pozitivizmi ligjor: Xhon Ostini dhe Bentami Kjo temë trajton teorinë e cila lindi si një kundërshtim i së drejtës natyrore duke shqyrtuar origjinat e pozitivizmit ligjor dhe duke dhënë karakteristikat e saj. Një vëmendje e vecantë i kushtohet qëndrimit të autorëve si Bentami dhe Ostini të cilët kontribuan në formulimin e kësaj teorie. Gjithashtu, jepen disa kritika mbi teorinë e Ostinit duke vënë në pah disa nga problemet që ajo kishte. (Fq. 84-123)						
5	Pozitivizmi ligjor modern: Harti Në vazhdim të kritikave mbi pozitivimin ligjor u themelua teoria e pozitivizmit ligjor modern e përfaqësuar nga Harti i cili shfaq qendrimin e tij lidhur me raportin e drejtë-sanksion të analizuar nga Ostini dhe raportin e drejtë-moral të analizuar nga përfaqësuesit e së drejtës natyrore. Në përfundim jepen disa vlerësime dhe kritika mbi këtë teori. (Fq. 124-142)						

6	Rilindja e koncepteve të së drejtës natyrore: Lon Fuller Teoria e Fullerit u shfaq si një ridimensionim i së drejtës natyrore. Në këtë leksion do të trajtohen parimet procedurale të formuluar nga Fullerit të cilat sillnin edhe moralin procedural si një koncept i ri që shfaqej në jurisprudencë. Në përfundim jepen disa vlerësime dhe kritika mbi këtë teori. (Fq. 143-184)
7	Teoria e kulluar e së drejtës (Hans Kelzen) Ky leksion ndalet tek teoria e kulluar e së drejtës duke përcaktuar metodologjinë e ndjekur nga Kelzeni dhe piramidën e burimeve të së drejtës duke sqaruar edhe hierarkinë mes këtyre burimeve. Në përfundim jepen disa vlerësime dhe kritika mbi këtë teori. (Fq. 185-209)
8	Provimi gjysmë final
9	Teoria e Dvorkinit për të drejtën dhe moralin Tema analizon pozicionin e Dvorkinit mbi teoritë ekzistuese si e drejta natyrore dhe pozitivizmi ligjor. Gjithashtu trajton parimet e Dvorkinit duke sqaruar secilin prej tyre. Në përfundim jepen disa vlerësime dhe kritika mbi këtë teori. (Fq. 210-229)
10	Utilitarizmi: Bentami dhe Mill Utilitarizmi i përfaqësuar nga Bentami dhe Milli është gjithashtu një nga teoritë më të rëndësishme të së drejtës. Ky leksion jep karakteristikat e utilitarizmit duke dhënë dhe raste konkrete të zbatimit të kësaj teorie. Krahas kësaj, sqarohen dhe disa dallime që gjenden në qëndrimet e dy përfaqësuesve të kësaj teorie, Bentami dhe Milli. Në përfundim jepen disa vlerësime dhe kritika mbi këtë teori. (Fq. 281-295)
11	Realizmi ligjor amerikan dhe skandinav Ky leksion trajton ndikimin e realizmit ligjor amerikan dhe skandinav në sistemet ligjore të këtyre vendeve duke përcaktuar edhe karakteristikat e tyre. (Fq. 260-280)
12	Teoria e Drejtësisë (Rolls) Teoria e Drejtësisë e përfaqësuar nga Rollsi pati po ashtu një kontribut të madh në lëmin e teorive të së drejtës. Në këtë leksion trajtohet përkufizimi i jep Rollsi drejtësisë si dhe metodat që ai ndjek për të realizuar drejtësinë në shoqëri. Në përfundim jepen disa vlerësime dhe kritika mbi këtë teori. (Fq. 347-365)
13	Cështje të debatueshme të filozofisë të së drejtës Ky leksion synon të adresojë disa cështje që janë objekt diskutimi në filozofinë e së drejtës. (Fq. 366-378)
14	Teoritë kritike moderne Ky leksion ndalet tek rryma e studimeve ligjore kritike dhe jurisprudenca feministe si një nga teoritë që solli risi në studimin e së drejtës. Krahas kësaj, trajtohet ndikimi që ka patur jurisprudenca feministe në reformimin e së drejtës. (Fq. 303-322)
15	Përsëritje
16	Final Exam
Prerequisites The student must attend the course at a minimum rate of 75%.	
Literature • 1. Luljeta Ikonimi, Filozofia e së drejtës (Tiranë: Onufri 2010)	
References • 1. M.D.A Freeman, Lloyd's Introduction to Jurisprudence (London: Sweet&Maxwell 2008) 2. Raymond Wracs, Understanding Jurisprudence (Oxford: Oxford University Press 2012) 3. Larry May and Jeff Brown, eds. Philosophy of Law: Classic and Contemporary Readings (Oxford: Wiley-Blackwell 2010)	
Course Outcome	
1	Kuptimi i marrëdhënies midis së drejtës dhe shoqërisë në aspektin e natyrës, zbatimit dhe qëllimit të së drejtës.
2	Dallimi mes së drejtës, moralit dhe drejtësisë si dhe përkufizimi i ligjit dhe efektivitetit të tij në lidhje me imperativët e tjerë sociologjikë dhe metafizikë.
3	Konceptimi i marrëdhënieve mes ligjit, aktorëve të tij dhe ndryshimeve shoqërore.
4	Zhvillimi i aftësive kritike dhe argumentuese të studentëve.
5	Përgatitja e studentëve për t'u bërë pjesë e diskutimeve të frytshme në fushën e jurisprudencës.
6	Pajisja e studentëve me terminologjinë e mjaftueshme ligjore për të vijuar me lëndët e tjera pasardhëse.

Course Evaluation			
In-term Studies	Quantity	Percentage	
Midterms	1	40	
Quizzes	0	0	
Projects	0	0	
Term Projects	0	0	
Laboratory	0	0	
Class Participation	1	10	
Total in-term evaluation percent			50
Final exam percent			50
Total			100
ECTS Workload (Based on Student Workload)			
Activities	Quantity	Duration (hours)	Total (hours)
Course duration (Including the exam week: 16x Total hours of the course)	16	3	48
Study hours outside the classroom (Preparation, Practice, etc.)	14	6	84
Duties	0	0	0
Midterms	1	0	0
Final Exam	1	0	0
Other	0	0	0
Total Work Load			132
Total Work Load / 25 (hours)			5.28
ECTS			5.00